

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7939  
E hënë, 25 nëntor 2024  
Çmimi 0.50

Kosova dhe Kanadaja  
do ta fillojnë Programin  
e Bashkëpunimit në  
Trajnim Ushtarak | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ENDE PA FILLUAR FUSHATA, KA SHQETËSIME PËR SHKELJE DHE NDËRHJRJE NË PROCES ZGJEDHOR | **FAQE 4-5**



Partitë politike në Kosovë po përgatiten për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, por parafushata e tyre ka shkaktuar

shqetësime për ndërhyrjen e mundshme në procesin zgjedhor dhe për keqpërdorimin e burimeve publike. Eugen Cakolli

nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se gati asnjë parti nuk bën përjashtim nga shkeljet e tilla të dyshuara, as qeveria


**MBËSHTETJE  
E MADHE  
PËR BEDRI  
HAMZËN  
NË HANOVER  
DHE KOLN** | **F. 7**



**NGA ÇDO  
KONTINENT  
KOSOVA PAGUAN  
QINDRA MILIONA  
PËR IMPORTIM  
TË VETURAVE** | **F. 6**



### AKTUALE



**SHTETET NË ZHVILLIM THONË SE  
300 MILIARDË DOLLARËT E NDARË  
PËR KLIMËN NUK MJAFTOJNË** | **F. 2**

**"SERBIA NUK LUAN DOT ME  
KOSOVËN", DEPUTETI GJERMAN:  
BISEDIME TË REJA PAS ZGJEDHJEVE** | **F. 5**

**NJOHËSIT E SIGURISË: SERBIA  
SYNON TA MBAJË VERIUN  
TË TENSIONUAR** | **F. 5**

### EKONOMI



**NUMËR I VOGËL I INSPEKTORËVE NË  
TERREN, JO TË GJITHA BIZNESET PO  
KONTROLLOHEN** | **F. 7**

**KONTRATAT NJËBURIMORE,  
MURATI: TASH E DISA MUJAJ KEMI  
DËGJUAR NGA OPOZITA SHPIFJE DHE  
PROPAGANDË** | **F. 7**

### SPORT



**PRISHTINA DHE BALLKANI  
NDAHEN BARAS, SOT PËRBALLEN  
DRITA DHE LLAPI** | **F. 10**

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky kërkon më shumë sisteme për mbrojtje ajrore të Ukrainës

KIEV, 24 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë më 24 nëntor se shtetit të tij "i duhen më shumë sisteme për mbrojtje ajrore", për t'i mbrojtur njerëzit e vet, teksa Rusia vazhdon ta shënjestrojë Ukrainën me bomba ajrore, dronë luftarakë dhe raketa. "Mbrojtja më e fuqishme e qiejve tanë është absolutisht kritike", ka thënë Zelensky, duke shtuar se Kievi është duke "punuar aktivisht" me partnerët për përmirësim të mbrojtjes ajrore të shtetit. Rusia ka nisur më shumë se 800 bomba ajrore, ka kryer rreth 460 sulme me dronë dhe rreth 20 raketa të llojeve të ndryshme kundër Ukrainës, vetëm javën e kaluar, sipas Zelenskyt. Si Ukraina, ashtu edhe Rusia, kanë raportuar më 24 nëntor se kanë zbrapsur disa sulme me dronë përgjatë natës.

Nuk ka raportime për të plagosur në asnjërën palë. Serhiy Popko, udhëheqës i administratës ushtarake të Kievit, ka thënë se alarmi ajror ka zgjatur më shumë se tri orë dhe që dronët "kanë lëvizur në drejtime të ndryshme" të qytetit. Forcat ukrainase patën kryer një inkursion të befasishëm në rajonin rus, Kursk, në gusht, duke marrë kontrollin e 1 400 kilometrave katrorë. Mirëpo një burim i ushtrisë ukrainase ka thënë se Kievi tani ka humbur 40 përqind të territorit që kontrollonte në Kursk. Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuara raportohet t'i kenë dhënë leje Ukrainës për të goditur thellë në Rusi me sistemet ATACMS dhe raketat Storm Shadow, respektivisht. Raketat janë armë taktike precize të dizajnuara të



godasin qendra, logjistikë dhe depo armësh rreth frontit të luftës. Ukraina veçse i ka përdorur këto armë për të kryer sulme në Kursk dhe rajonin fqinj, Belgorod. Edhe Franca u është bashkuar ShBA-së dhe Britanisë, duke

sinjalizuar se Ukraina mund t'i përdorë armët me rreze të gjatë kundër shënjestrave në territorin rus. Ministri i Jashtëm francez, Jean-Noel Barrot, ka thënë në një intervistë për transmetuesin britanik BBC se Ukraina mund të lëshojë

raketa franceze me rreze të gjatë në Rusi, "për vetëmbrojtje". Megjithatë, ai nuk ka konfirmuar nëse armët franceze janë përdorur tashmë. Rusia, në anën tjetër, e ka dënuar ashpër përdorimin e këtyre armëve nga Ukraina, dhe është zotuar se do të kryejë sulme me raketa të avancuara si dhe ka përditësuar doktrinën bërthamore. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Shtetet në zhvillim thonë se 300 miliardë dollarët e ndarë për klimën nuk mjaftojnë

BAKU, 24 NËNTOR - Shtetet e pasura që kanë marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Klimën (COP29) janë pajtuar për të ndarë 300 miliardë dollarë në vit për t'i financuar shtetet e varfra teksa përballen me efektin e ndryshimeve klimatike. Shtetet pranuese të fondeve e kanë kritikuar marrëveshjen, duke thënë se fondet janë të pamjaftueshme. Marrëveshja, e arritur pas konferencës dyjavore, që është mbajtur në Baku, kryeqytetin e Azerbajxhanit, është përshkruar një hap i rëndësishëm në përpjekjet për ta zvogëluar ritmin e ngrohjes globale. Disa delegatë e kanë



duartrokitur marrëveshjen, por të tjerë kanë thënë se vendet e pasura nuk po bëjnë mjaftueshëm. "E them me keqardhje që ky dokument nuk është asgjë përveç një iluzion optik", ka thënë përfaqësuesja

e Indisë, Chandni Raina, pak pasi është arritur pajtueshmëria. "Sipas mendimit tim, ajo nuk do t'i adresojë sfidat madhore me të cilat përballemi. Prandaj e kundërshtojmë miratimin".

Shefi i OKB-së për çështje të Klimës, Simon Stiell, i ka pranuar vështirësitë në negociatë, mirëpo ka thënë se rezultati është një lloj sigurimi për njerëzimin kundër ngrohjes globale. "Ka qenë rrugëtim i vështirë, mirëpo kemi marrëveshje", ka thënë Stiell. "Kjo marrëveshje do të nxisë prodhimin e energjisë së pastër dhe do t'i mbrojë miliardë jetë". Marrëveshja parasheh që vendet e pasura duhet t'i ndajnë së bashku 300 miliardë dollarë për çdo vit deri më 2035, në krahësim me zotimin prej 100 miliardë dollarësh të vitit 2020. Marrëveshja parasheh që konferenca e ardhshme e OKB-

së të mbahet në Brazil, përgjatë së cilës vendet pjesëmarrëse do t'i përcaktojnë hapat që do të ndërmarrin në dekadën e ardhshme kur është fjala për çështje klimatike. Shumica e vendeve të botës po bëjnë përpjekje që ta zbatojnë premtimin e bërë në Marrëveshjen e Parisit për Klimën, që parasheh kufizimin e temperaturës globale të Tokës në 1.5 gradë celsius, pasi çdo rritje më e madhe mund të rezultojë me pasoja katastrofale për natyrën. Nëse nuk merren hapa për ta ndryshuar situatën aktuale, shkencëtarët parashohin që temperatura globale do të arrijë në 3.1 gradë celsius deri në fund të shekullit.

## Në Barcelonë protestohet kundër rritjes së çmimeve të qirasë

Barcelonë, 24 nëntor - Dhjetëra mijëra njerëz kanë dalë nëpër rrugët e Barcelonës në mbremjen e së shtunës me kërkesën për çmime të përbalueshme të banimit. Policia ka thënë se rreth 22 000 njerëz kanë marrë pjesë në protesta, ndërsa organizatorët kanë thënë se kanë qenë 170 000 pjesëmarrës. Protestuesit kanë kërkuar që çmimet e qirave të përgjysmohen, ka raportuar e përditshmja "El País".

Protestuesit kërkojnë edhe që banesat në zonat turistike të jenë të qasshme sërish për banorët e Barcelonës, kryeqytetit të rajonit të Katalonjës, në verilindje të Spanjës. Një kërkesë tjetër e tyre ka qenë që kontratat e qirave të nënshkruhen për periudhë të pakufizuar. "Është e papranueshme për ne që ta shpenzojmë gjysmën e rrogës në qira dhe të shpërngulemi secilën herë që na skadon kontrata", ka thënë Carme

Arcarazo, përfaqësuese e protestuesve. Sipas gazetës "El País", situata është duke u bërë secilën herë e më e vështirë në tregun e Barcelonës, pasi shtëpitë e banimit po shfrytëzohen për turizëm, si dhe për shkak që të huajt po blejnë shumë prona në këtë qytet. Në muajt e fundit protesta të ngjashme janë mbajtur edhe në qytete e ishuj të tjerë të Spanjës. Në disa është kërkuar edhe që t'i jepet fund turizmit masiv.



## Kosova dhe Kanadaja do ta fillojnë Programin e Bashkëpunimit në Trajnim Ushtarak

Prishtinë, 24 nëntor - “Një lajm i mrekullueshëm sot nga Halifaxi: Kosova dhe Kanadaja do ta fillojnë Programin e Bashkëpunimit në Trajnim Ushtarak”, ka

shkruar presidentja Vjosa Osmani në “Facebook”. Ajo ka treguar se së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në

Halifax, takuan ministrin e Mbrojtjes të Kanadasë, Bill Blair, i cili ua dha lajmin e mirë rreth këtij programi, pas kërkesës që ia ka bërë ish-ministres së Mbrojtjes gjatë

vizitës së mëparshme në Kanada. “Kosova dhe Kanadaja - një partneritet në rritje në dobi të qytetarëve, paqes dhe sigurisë!”, thotë Osmani.



## Mbështetje masive për Bedri Hamzën në Hanover dhe Koln



EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, në kuadër të turneut të nëntorit në mërgatë, dje dhe sot është prituri në mënyrë madhështore edhe në Hanover dhe Koln të Gjermanisë.

Mijëra bashkatdhetarë i kanë uruar mirëseardhje Hamzës, i cili i falënderoi për pritjen dhe mbështetjen për të dhe vizionin e tij në zgjedhjet e 9 shkurtit.

Në të dy tubimet, Hamza tha se Kosova ka nevojë për bashkatdhetarët jo vetëm si mbështetës financiarë, por si partnerë aktivë për transformimin ekonomik të vendit. “E çmoj shumë kontributin e diasporës në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë”, ka thënë Hamza,

duke i ftuar ata që të investojnë në Kosovë. “Gjithandej po takoj njerëz të suksesshëm në mërgatë. Ju lus, ju garantoj dhe ju siguroj se do të krijoj kushte që ju të vini të hapni biznese dhe të investoni në Kosovë. Përtej kapitalit, kemi nevojë për dijen dhe menaxhimin tuaj modern”, tha Hamza.

Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës i ftoi mërgimtarët që të regjistrohen deri më 26 dhjetor, në mënyrë që të sigurojnë të drejtën e votës më 9 shkurt. “Mos e pritni 26 dhjetorin që të regjistroheni. Regjistrohuni edhe më herët që ta siguronit të drejtën tuaj për votim. Me këtë entuziazëm, masivitet dhe mbështetje që po na jepni, ne do të fitojmë”, ka thënë Hamza.

Pas tubimit në Hanover dhe Koln, Hamza do të zhvillojë tubime të tjera në mërgatë. Më 30 nëntor Hamza do të jetë në mesin e bashkatdhetarëve në Vjenë.

## Shqipëria synon turizëm elitare

TIRANË, 24 NËNTOR - Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, Mirela Kumbaro, thotë në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” se turizmi është kthyer në industri dhe është shtrirë thuajse në të gjithë territorin, po ashtu përgjatë gjithë vitit.

Ajo pret që fluksi i turistëve të huaj të rritet, ndërsa pranon se vendi nuk ishte i përgatitur që ta përballonte bumën turistik që përjetoi në dy vjetët e fundit.

Thotë se qëllimi është turizmi elitare, por paralajmëron lajme të mira edhe për ata që kërkojnë më shumë hapësira publike në bregdet.

Si problemet kryesore që kërkojnë zgjidhje për t’u përballur me fluksin në rritje të turizmit, Kumbaro përmend menaxhimin e mbetjeve dhe transportin publik. “Për reputacionin e imazhit të Shqipërisë në botë, por edhe për zhvillimin ekonomik, padyshim, turizmi është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë. Prej dy



vjetësh kemi filluar të flasim jo thjesht për turizmin si sektor të ekonomisë, por për industri.

Kjo do të thotë se ajo që kemi paralajmëruar rreth tetë vjet më parë, se do të ishte e ardhmja e

Shqipërisë dhe zhvillimit ekonomik, sot është bërë e prekshme në ekonomi, por edhe për organizmat ndërkombëtarë, që janë matës të zhvillimit të sektorit, siç është Organizata

Botërore e Turizmit. Në barometrin e vet për 6 muajt e parë, ajo e ka renditur Shqipërinë të dytën në botë për rritjen e fluksit turistik ndërkombëtar dhe të parën në Evropë, krahasuar me

periudhën para pandemisë [COVID-19]. Shqipëria jo vetëm se është rikuperuar, por ka shkuar përtej të gjitha pritjeve. Sipas parashikimeve tona, ne do t’i arrinim 10 milionë turistë në vitin 2027 ose 2030, por ja ku jemi, e kapëm [këtë shifër] që në vitin 2023. Kjo falë jo një bume që ndodhi në një vit, por falë një pune që është bërë që nga viti 2014, e që ne e konceptuam si program i ‘Rilindjes Urbane’. Ai solli transformim psiko-estetik, psiko-arkitekturor dhe një sinergji të re në marrëdhëniet në investime dhe vizion mes sektorit privat dhe publik. Dy fenomene të reja shumë të rëndësishme, të konfirmuara në dy vjetët e fundit, janë: shtrirja e turizmit në territor dhe gjatë gjithë vitit. Këto e bëjnë turizmin të qëndrueshëm, krijojnë hartë të re, bëjnë që turistët ta shohin Shqipërinë jo vetëm për bregdetin, por për shumë destinacione të pazbuluara më parë”, ka deklaruar Kumbaro.

## NATO mbetet aleat i pazëvendësueshëm, anëtarësimi është prioritet strategjik për Kosovën

Prishtinë, 24 nëntor - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po e përfaqëson Kosovën në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifax, ka zhvilluar

një takim me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralin Rob Bauer. Sipas presidentes Osmani, prania e NATO-s, përmes KFOR-it në Kosovë, ka qenë gjithmonë e

rëndësishme për paqen dhe sigurinë, ashtu siç do të jetë edhe anëtarësimi i Kosovës në këtë Aleancë historike.

Në takim me admiralin Bauer, presidentja Osmani shprehu

mirënjohjen e thellë për rolin e NATO-s në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe përkushtimin e vazhdueshëm për paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë.





# Ende pa filluar fushata, ka shqetësime për shkelje dhe ndërrhyrje në proces zgjedhor

**PRISHTINË, 24 DHJETOR** - Partitë politike në Kosovë po përgatiten për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, por parafushata e tyre ka shkaktuar shqetësime për ndërhyrjen e mundshme në procesin zgjedhor dhe për keqpërdorimin e burimeve publike.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se gati asnjë parti nuk bën përjashtim nga shkeljet e tilla të dyshuara, as qeveria.

Instituti i tij është pjesë e rrjetit të organizatave Demokracia në Veprim, që bën vëzhgimin e proceseve zgjedhore.

Cakolli, si ndërhyrje të qeverisë në procesin zgjedhor, merr shembull përpjekjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) për miratimin e një memorandum bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përmes të cilit synonte të sigurote "bashkëpunim mes palëve në organizimin dhe administrimin e të gjitha formave të votimit" për shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit.

Ndërsa keqpërdorimi i burimeve publike për qëllime të fushatës zgjedhore thotë se është i pranishëm te të gjitha partitë, ndonëse më i theksuar sërish te pushteti apo Lëvizja

Vetëvendosje.

Përfaqësuesit e partive që iu përgjigjën kërkesave të "Radios Evropa e Lirë" për komente, i mohojnë këto pretendime.

## Memorandumi për zgjedhjet jashtë vendit

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve konfirmojnë se kanë pranuar memorandumimin e MPJD-së për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në diasporë, por thonë se nuk e kanë marrë fare në shqyrtim. "Memorandumi ka pasur elemente për të cilat kemi konsideruar se në disa pika e cenonin sovranitetin e KQZ-së", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Ilir Gashi, anëtar i kryesisë së KQZ-së, por nuk specifikon më shumë. Disa medie në Prishtinë raportuan se MPJD-ja në atë memorandum i ka caktuar vetes kompetenca që me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk i takojnë. Mes të tjerash, mediet përmendën sigurimin e "hapësirës së përshtatshme për zhvillimin e procesit zgjedhor në përputhje me të drejtën e aplikueshme ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor". MPJD-ja nuk iu përgjigj kërkesës së "Radios Evropa e

Lirë" për të komentuar.

Për Cakollin, kërkesa për memorandum të tillë është e paprecedente.

Të tillë e cilëson edhe ish-kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka. Ajo thotë se në të kaluarën, kur janë organizuar zgjedhje parlamentare, nuk ka pasur përpjekje të ngjashme nga ndonjë dikaster qeveritar. "Fakti që ka tendencë nga pushteti për t'i futur duart në zgjedhje, e dëmton procesin zgjedhor", sipas Dakës.

## Burimet publike

Cakolli thotë, po ashtu, se Qeveria e Kosovës ka keqpërdorur burimet publike për të marrë vendime që kanë ndikim elektoral. Në këtë aspekt, ai përmend vendimin për rritjen e pagës minimale në 350 euro, pastaj për rritjen e pensioneve për 20 për qind dhe për rritjen e pagave në sektorin publik për 55 euro nga janari i vitit të ardhshëm dhe për 55 të tjera nga korriku. Të gjitha këto vendime janë marrë në muajt e fundit dhe, sipas Cakollit, kjo tregon për "tendencë të qarta" të Qeverisë për t'i ndikuar votuesit. "Po të ishin paraparë më herët, mbase nuk do të kishte problem", thotë ai. Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se si i

komenton këto pretendime të sektorit civil.

Cakolli thotë se ka pasur, gjithashtu, një rritje të sponsorizimeve të postimeve në platformat digjitale nga Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me ç'rast kanë shpenzuar mijëra euro deri më tani.

Për më tepër, sipas tij, LDK-ja dhe AAK-ja kanë deklaruar se në listat e tyre zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit, do t'i përfshijnë si kandidatë për deputetë edhe disa kryetarë komunash. "Kjo si formë, në radhë të parë, paraqet keqpërdorim të besimit publik", thotë ai dhe shton se angazhimi në fushatë, këtyre kandidatëve u krijon mundësi për përdorimin e burimeve publike.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës konfirmojnë se së paku katër kryetarë aktualë të komunave do të jenë në listën e saj zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit.

Nënkryetari i kësaj partie, Lutfi Haziri, thotë se kandidimi i tyre për deputetë të Kuvendit, nuk përbën ndonjë shkelje ligjore. "Në momentin që zgjidhen, mbetet në vullnetin e tyre të vendosin se a duan ta mbajnë mandatin e kryetarit apo ta marrin mandatin e deputetit",

thotë Haziri.

Ai shton se ligjërisht, por edhe sipas parimeve të partisë që përfaqëson, përdorimi i burimeve publike nga kandidatët për deputetë është krejtësisht i ndaluar.

Ngjashëm shprehen edhe në PDK dhe AAK sa i përket përdorimit të burimeve publike, ndërsa nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, nuk u përgjigjën.

## Si mund të parandalohen këto tendenca?

Aktivitetet e partive politike para se të nisë zyrtarisht fushata zgjedhore nuk janë të rregulluara me ligj.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i cili është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur lidhur me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, mund të shqiptojë gjopa vetëm ndaj partive të certifikuara dhe që shkeljet i kryejnë gjatë fushatës zgjedhore zyrtare.

Afati për aplikim të subjekteve politike për certifikim dhe dorëzim të listave të kandidatëve për deputetë në KQZ, për zgjedhjet e 9 shkurtit, është deri më 24 dhjetor.

Cakolli thotë se, për aq kohë sa subjektet politike nuk janë

## “Serbia nuk luan dot me Kosovën”, deputeti gjerman: Bisedime të reja pas zgjedhjeve

Prishtinë, 24 nëntor - Nisja e punës së Komisionit të Zgjedhur Evropian mund të shërbejë si përshpejtues i dialogut Kosovë - Serbi. Deputeti i Bundestagut të Gjermanisë, Thomas Hacker, vlerëson se deri atëherë nuk do të ketë lëvizje në këtë drejtim. “Jemi në periudhë tranzitore të Komisionit Evropian, pra komisioni tjetër është në orët e fundit, do të kemi një komisionar me politikë zgjerimi, një grua nga Sllovenia që ka njohuri për rajonin dhe, po ashtu, Miroslav Lajçak nuk do të jetë në krye të dialogut Prishtinë - Beograd. Kështu do të kemi mundësi për një rifillim”, tha ai për “Top Channel”. Ai shtoi se ky rifillim i dialogut do të bëhet vetëm mbas zgjedhjeve të qeverisë së re në

Kosovë. “Në Kosovë do të ketë zgjedhje dhe deri atëherë nuk mund të bëhet shumë, por pas zgjedhjeve dhe me komisionin e ri duhet të rforcohet procesi. Duhet të bëhet e qartë se marrëveshjet e arritura duhet të përmbushen e implementohen nga të dyja palët”, tha ai. Sa i përket moszbatimit të marrëveshjeve nga të dyja anët për normalizimin e marrëdhënieve, deputeti gjerman thotë se durimi do të mbarojë shpejt. “Faktikisht pas zgjedhjeve në Kosovë dhe formimit të qeverisë së re do të mbarojë durimi për të dyja palët. Serbia nuk mund të thotë ne do ta nënshkruajmë marrëveshjen e më vonë të thotë ne nuk e nënshkruajmë e pastaj të thotë se është kundër kushtetueses”, tha Hacker.



## Njohësit e sigurisë: Serbia synon ta mbajë veriun të tensionuar

PRISHTINË, 24 NËNTORI - Deklarimet e presidentit serb Aleksandar Vuçiq, se ushtria e tij është gati për të reaguar në përputhje me Marrëveshjen Ushtarako-Teknike të Kumanovës, janë tentativa për ta mbajtur gjallë “Serbinë e

Madhe”, vlerësojnë njohësit e sigurisë në Kosovë. “Ata do të tentojnë çdoherë që veriun e Kosovës ta aneksojnë në Serbi. Do të tentojnë çdoherë të bëjnë manovrimet të ndryshme, qofshin ato terroriste apo krime të ndryshme për ta mbajtur

Kosovën në përgjithësi, e veriun në veçanti në tension”, tha ish-ushtaraku, Kadri Kastrati. Megjithatë, sipas profesorit të shkencave të sigurisë, Avni Islami, e gjithë kjo është në vazhdim të propagandës së një ish-ministri të Millosheviqit.

“Dhe ai po përpiqet të fitojë në kohë para se të fillojnë bisedimet serioze ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Me ardhjen e presidentit Trump në krye të ShBA-së të gjithë po presin që çështja e dialogut ndërmjet Kosovës e Serbisë të përfundojë sa më

shpejt me njohje të ndërsjellë mes tyre”, tha Islami për RTK-në. Së fundmi kryeministri Albin Kurti ngriti shqetësimin se fqinji verior i Kosovës e mendon hakmarrjen dhe ka përpjekje për tensione.

Një gjë e tillë edhe mund të ndodhë thonë njohësit, por jo në përmasa të një sulmi si ai në Banjska të vitit të kaluar. “Me rastin e fundit të shtatorit të vitit të kaluar ata e kanë marrë një goditje të fuqishme nga shteti i Kosovës, ku janë kapur disa terroristë, disa janë vlarë dhe disa të tjerë janë në ndjekje prej gjykatave dhe do të dënohen qoftë edhe në mungesë, por besoj që faktori ndërkombëtar të bëjë presion që ata të ekstradohen në Kosovë. Mendoj se Serbia do të tentojë edhe në të ardhmen, me grupe jo aq të mëdha, por me grupe më të vogla, që t’i futet brenda Kosovës që të bëjë ndonjë manovrim bazuar në situatën qoftë ajo rajonale apo globale”, tha Kastrati.

Dy ditë më parë Ministria e Mbrojtjes së Serbisë pretendoi se një grup i policëve të Kosovës të armatosur rëndë kanë kaluar në mënyrë të paautorizuar vijën kufitare në fshatin Çirkoviq në Leposaviq, por Policia e Kosovës tha se janë të pavërteta pretendimet e autoriteteve serbe.



të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhje dhe shkeljet eventuale nuk i bëjnë gjatë fushatës zgjedhore zyrtare, ato “amnistohen”. Ai thekson se tendencat e shprehura deri më tash për ndërhyrje në procesin zgjedhor, e dëmtojnë integritetin e tij, por “nuk janë të atij niveli për të qenë 100 për qind përcaktuese të rezultatit

zgjedhor”. Megjithatë, thotë se aktorët politikë do të duhej të ndërmerrnin hapa për ndërprerjen e tyre, “duke u thirrur në vlerat e mira të transparencës dhe integritetit zgjedhor”. “Ne patëm menduar edhe idenë që partitë politike të nënshkruanin një lloj deklarate, përmes së cilës do të

zotoheshin... por që e njëjta nuk do të kishte karakter obligativ”, thotë Cakolli. Por, sipas tij, mënyra e vetme për t’i ndaluar veprimet që dëmtojnë integritetin zgjedhor, mbeten ndryshimet ligjore. Ato, thotë ai, do të duhej të përcaktonin se kufizimet për shfrytëzimin e resurseve publike, obligimet për

raportimin financiar dhe të gjitha dispozitat tjera rregulluese, vlejné që nga dita e shpalljes së zgjedhjeve nga ana e presidentit të vendit, e jo vetëm që nga fillimi i fushatës zgjedhore zyrtare, e cila zgjat vetëm 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Cakolli thotë se për ndryshime të tilla tani nuk ka kohë, por se

ato do të mund të bëheshin për zgjedhjet e tjera në të ardhmen. Periudha e fushatës zgjedhore për partitë politike dhe kandidatët e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e 9 shkurtit, do të fillojë zyrtarisht më 11 janar, 2025. Nga ato zgjedhje do të dalë përbërja e re e Kuvendit të Kosovës, që ka 120 deputetë.

## Nga çdo kontinent, Kosova paguan qindra miliona për importim të veturave

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Mbi 27 mijë vetura, gati 364 milionë euro. Nga Amerika e Veriut dhe e Jugut, Azia, Afrika e Australia... Përgjatë dhjetë muajve të parë të 2024-s, në Kosovë kanë hyrë dhjetëra mijëra vetura nga vende të huaja. Si në vitet e kaluara, edhe gjatë këtij viti Gjermania mbetet eksportuesja më e madhe e veturave në Kosovë. Ndonëse Gjermania mban vendin e parë, vitet e fundit janë importuar shumë vetura edhe nga vendet aziatike si Kina, Koreja e Jugut dhe Japonia. Për importimin e këtyre veturave u shpenzuan qindra miliona euro. Nëse vazhdon trendi i njëjtë edhe gjatë pjesës së fundit të këtij viti, 2024-ta do të bëhet viti me më së shumti shpenzime për importim të veturave nga jashtë. Këto shpenzime kanë rezultuar edhe në të ardhura për shtetin,

për shkak të taksave që paguhen kur importohen veturat - taksat e doganës, akciza dhe TVSh-ja (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar). Taksa e doganës është një tarifë që aplikohet bazuar në vlerën e mallit kur ai të importohet dhe të eksportohet. Akciza është një tarifë e veçantë që zbatohet mbi disa produkte që cilësohen si mallra luksi. Ndërsa TVSh-ja është një tatim që paguhet nga blerësi i fundit i një shërbimi apo një produkti. Të gjitha këto taksa së bashku gjenerojnë të ardhura për shtetin. Në Kosovë ato kanë gjeneruar tashmë më shumë të ardhura sesa në vitet e kaluara, ende pa i llogaritur dy muajt e fundit të vitit. Për veturat elektrike, në Kosovë është paraparë lirimi nga taksat e regjistrimit, në mënyrë që të nxitet blerja e tyre, si ndotëse më të vogla të ambientit. Megjithatë, shumica e veturave



të importuara në Kosovë nuk janë elektrike. Pjesa më e madhe e tyre as nuk janë të reja, por të përdorura. Ligji për Automjetet në Kosovë

parashihet që veturat e importuara që janë më të vjetra se dhjetë vjet nuk mund të regjistrohen. Përkundër kësaj, në dhjetë

muajt e parë të këtij viti janë importuar 42 vetura të tilla. Pa mundësinë e regjistrimit, ato mund të përdoren vetëm për pjesë këmbimi.

## Tre muaj asnjë aplikim, subjektet politike ende nuk kanë dërguar listat e kandidatëve për deputetë

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ndonëse që nga 1 shtatori i këtij viti është hapur afati për aplikim të certifikimit dhe dorëzimit të listës së subjekteve politike me emrat e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk ka pranuar asnjë aplikim.

Këtë e ka konfirmuar për "KosovaPress", zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai tha se deri më 11 dhjetor të këtij viti të gjitha subjektet politike duhet të dorëzojnë në KQZ aplikimin e tyre për certifikim dhe listën me emrat e kandidatëve për deputetë. "Deri më 11 dhjetor të këtij viti të gjitha subjektet politike, në këtë rast partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, duhet ta dorëzojnë në KQZ aplikimin e tyre për t'u certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe në Komisionin Qendror të



Zgjedhjeve subjektet politike duhet t'i dorëzojnë edhe listat e tyre të kandidatëve për deputetë. Kjo periudhë ka filluar më 1 shtator dhe mund të konfirmoj se deri më tani nuk kemi ndonjë aplikim nga ana e ndonjë subjekti politik", tha Elezi. Lidhur me këtë, "KosovaPress" ka provuar të marrë përgjigje se

kur pritet që subjektet politike t'i kryejnë këto lloje të "obligimeve për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare". Nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përmes një përgjigje me shkrim thonë se lista do të dorëzohet brenda afatit të KQZ-së, porse nuk bën të ditur ndonjë datë specifike.

E pavarësisht interesimit, deri në publikimin e këtij artikulli, "KosovaPress" nuk pranoi përgjigje nga partitë e tjera politike lidhur me këtë çështje. Ndërkohë, Elezi potencoi se pas pranimit të aplikimeve, të gjithë personat që duan të certifikohen si kandidatë për deputetë do t'i nënshtrohen verifikimit të institucioneve të ndryshme. Ai tha se ky është një detyrim ligjor, me qëllim që të vërtetohet nëse kandidatët që garojnë për deputetë janë në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në mesin e institucioneve që KQZ-ja do të kërkojë verifikim të kandidatëve është edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). "Këshilli Gjyqësor i Kosovës është një prej institucioneve që KQZ-ja do të kërkojë verifikim të kandidatëve. Në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet se kandidat nuk mund të jetë një person nëse është dënuar në 3 vjetët e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim

efektiv'. Prandaj, me qëllim të zbatimit të këtij kufizimi ligjor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të kërkojë nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që ta verifikojë listën e kandidatëve nëse ndonjëri prej tyre nuk është në përputhje me këtë kufizim ligjor", potencoi Elezi. Sipas nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, një person nuk mund të certifikohet si kandidat për deputet i cili ka funksion të veçantë në bazë të Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë si anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik, kryesues apo anëtar i KQZ-së dhe Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, zyrtar i PZAP-së, me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it, i është hequr e drejta për të qenë kandidat, është dënuar në tre vjetët e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv, ka dështuar ta paguajë gjobën e vënë nga PZAP-i, apo KQZ-ja ose ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP-it.

## Haradinaj: Koalicioni ynë është opsioni i vetëm për ta bërë realitet një Kosovë fituese

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, të dielën iu ka bashkuar partnerëve të koalicionit në konventën politike të Nismës Socialdemokrate. Haradinaj ka thënë se koalicioni i përbashkët me Nismën dhe të tjerët, i përbërë nga figura të

dëshmuara që kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë e lavdishme të Kosovës, është opsioni i vetëm për t'i arritur synimet dhe për ta bërë realitet një Kosovë fituese, ëndërr e shumë gjeneratave. "Anëtarësimi direkt në NATO, jo vetëm si aspiratë, por edhe si

proces përmes Planit Aksional, do ta sjellë kthesën e madhe jo vetëm në siguri, por edhe në ekonomi dhe në çdo sferë tjetër të jetës. Ju sigurojmë se do ta bëjmë realitet. Nuk është veç fjalë. Çdoherë kemi dëshmuar se mund ta bëjmë!", ka thënë Haradinaj.



# Numër i vogël i inspektorëve në terren, jo të gjitha bizneset po kontrollohen

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Një pjesë e konsiderueshme e lokaleve të gastronomisë nuk po kontrollohen në kryeqytet. Këtë Ministria e Shëndetësisë e ka arsyetuar me numrin e vogël të inspektorëve sanitarë. Parashihet që vetëm brenda muajit një biznes të kontrollohet disa herë. Megjithatë, në kryeqytet kjo nuk po ndodh, veçanërisht në javët sa ishte e ndaluar të përdorej uji për pije e gatim që vjen nga Badovci. "Kemi inspektorë, ndonjëherë më rrallë, ndonjëherë më shpesh. Vitin e kaluar goxha shpesh kemi pasur e këtë vit jo, 4-5 herë në total. Prej kur u bë lajmi për mospërdorimin e ujit të Badovci, jo", ka thënë një pronar biznesi.

"Ka katër muaj askush s'na ka kontrolluar as për ujë as për ushqim", ka thënë një pronar biznesi për RTV Dukagjinin. "Ka kohë që e kemi mbyllur kuzhinën dhe nuk po shërbejmë ushqim. Sa e kemi pas hapur ka pasur kontrole se zakonisht për kuzhinë bëhet, por prej që e kemi mbyllur nuk ka ardhur askush", ka thënë një pronar tjetër biznesi.

Pavarësisht prej misionit, se numri i inspektorëve sanitarë nuk po arrin

t'i mbulojë nevojat, ka thënë edhe Ministria e Shëndetësisë. "Inspektorati Sanitar ka 49 inspektorë, mirëpo në raport me numrin e subjekteve që i inspektojmë, ky numër është i vogël. Bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe detyrave me prioritet të lartë, Inspektorati Sanitar përgatit planin e kontrolleve zyrtare, duke shqyrtuar me prioritet të lartë ankesat e konsumatorëve dhe rastet ad-hoc, rastet e jashtëzakonshme dhe kërkesat e subjekteve të rëndësishme të veçantë. Detyrë e Inspektoratit është mbrojtja dhe ruajtja e shëndetit publik, rritja e sigurisë së ushqimit, zbatimi i legjislacionit për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit për konsumatorët, si dhe mbikëqyrja e eksportit të produkteve vendore në vendet e Bashkimit Evropian. Shumica e inspektimeve realizohen në kryeqytet, fillimisht në sektorin e gastronomisë dhe në të gjitha institucionet publike të tjera. Bazuar në kontrollimet e kryera gjatë këtij viti, ka pasur një numër të vogël të rasteve të dyshimit të helmimeve. Gjithashtu, janë realizuar inspektime në zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit dhe në sektorë



të tjerë", thuhet në përgjigjen nga Ministria e Shëndetësisë.

Ndonëse numri i vogël i inspektorëve mbetet arsyeja, inspektorët sanitarë janë në numër më të madh sesa inspektorët e AUV-it. E nga kjo e fundit thonë se përgjegjësinë mbi gastronominë e kanë inspektorët sanitarë. "Numri

është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar nevojat që kërkohen. Planet nacionale po i bëjmë në atë formë që të kemi kapacitet. Të kishim inspektorë më shumë do të mund të mbulonim më shumë biznese që aktualisht e kemi të pamundur. Një regjion e mbulojmë me një ose dy inspektorë. Lokalet e

gastronomisë janë duke u kontrolluar nga inspektorët sanitarë që janë pjesë e MSh-se. Ata kanë numër më të madh", ka thënë Lamir Thaçi, zëdhënës në AUV.

Institucionet vazhdimisht janë ankur për numër të vogël të stafit, përfshirë edhe Inspektoratin e Punës.

## Kontratat njëburimore, Murati: Tash e disa muaj kemi dëgjuar nga opozita shpifje dhe propagandë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se tash e disa muaj kanë dëgjuar nga opozita shpifje dhe propagandë për prokurimin që bëhet përmes procedurave të negociuara. Sipas tij, në prononcimet e tyre kontratat me procedurë të negociuar ata i quajnë gabimisht, qëllimshëm herë kontrata njëburimore, herë tenderë sekretë, dhe shpesh përdorin shifra të mëdha e flasin për keqpërdorime, për ta krijuar përshtypjen te publiku se këtu me të vërtetë duhet të ketë diçka. "Por e tëra është shpifje e propagandë, në kuadër të luftës ndaj qeverisë Kurti me të gjitha mjetet. E para, prokurimi me procedurë të negociuar është i paraparë në Ligjin për Prokurimin Publik, saktësisht Nenin 34 dhe Nenin 35, pra nuk ka asgjë të paligjshme kur një autoritet kontraktues përdor këtë metodë, për aq sa plotësohen kriteret e kërkuara me ligj. Me fjalë të tjera, lloji i procedurës së prokurimit nuk e përcakton se a ka korrupsion në atë kontratë apo jo. P. sh., e kemi rastin e komunës së Prishtinës, ku me tender të hapur është dhënë kontrata në vlerë 12 milionë euro, për të paguar konsulencë e tenderë në



komputer dhe askush nuk mund të garantojë që në këtë kontratë nuk ka korrupsion. E dyta, shifrat e përdorura në kuadër të propagandës, për numrin e kontratave me procedurë të negociuar dhe vlerën e tyre, përfshijnë të gjitha institucionet e

qeverinë qendrore, institucionet e pavarura, komunat dhe ndërmarrjet publike. Prandaj edhe përdorimi i këtyre shifrave, duke thënë se janë qindra miliona euro e mijëra kontrata duke ia atribuuar qeverisë qendrore, është manipulim vetëm e vetëm për të krijuar përshtypjen te

qytetari se kemi të bëjmë me një keqpërdorim të madh, përndryshe kush ka guxim të gënjejë për diçka kaq të madhe", ka shkruar Murati në "Facebook".

Ai ka thënë se nëse e shikojmë ndër vite se si ka qenë raporti i kontratave me procedurë të

negociuar, del se niveli më i lartë i përdorimit të kësaj lloji metode, pra tenderë njëburimorë apo tenderë sekretë, "siç ka qejf t'i quajë opozita, ka qenë në vitet 2008, me 19.9 % dhe në vitin 2015 me 16.1 %".

Murati ka thënë se edhe në vitin 2008 edhe në vitin 2015 në qeverisje ka qenë koalicioni PDK - LDK. "Madje në vitin 2015 ka qenë ministre edhe deputetja Bajrami, e cila është aq e zellshme të 'denoncojë' këtë metodë të prokurimit. E nëse me të vërtetë duhen konsideruar kontratat me procedurë të negociuar si potencial për korrupsion, atëherë hetimet do të duhej të fillonin pikërisht nga këto vite, 2008 dhe 2015, për ta gjetur korrupsionin më të lartë. Por Prokuroria Speciale nuk i bën ato hetime, sepse Prokuroria Speciale nuk është e interesuar t'i luftojë krimin e korrupsionin", ka deklaruar Murati.

Ai ka pohuar se Prokuroria Speciale është e interesuar ta luftojë Albin Kurtin për t'ia bërë një argat opozitës. "Kjo dëshmohet edhe në shkresat që ua dërgojnë institucioneve kur kërkojnë dokumentacionin për 'kontratat njëburimore' (termi i përdorur nga opozita), e jo 'kontratat me procedurë të negociuar' siç është termi zyrtar", ka thënë Murati.

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT  
 PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



# Prishtina dhe Ballkani ndahen baras, sot përballen Drita dhe Llapi



## SUPERLIGA

Prishtina - Ballkani	1-1
Malisheva - Dukagjini	2-1
Suhareka - Ferizaj	0-0
Feronikeli 74 - Gjilani	0-3

**Të hënën takohen:**  
 13:00 Drita - Llapi

### **EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Derbi mes Prishtinës dhe Ballkanit që u zhvillua të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" ka përfunduar baras 1-1. Mysafirët që janë kampionë në fuqi të Superligës, kaluan në persi me anë të Bleart Tolaj, i cili realizoi gol të bukur në minutën e 32-të, realizues ishte Leotrim Kryeziu. Vendasit nuk

u dorëzuan dhe shënuan golin e barazimit pas një ore lojë. Në vijim të ndeshjes rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-1. Pas kësaj ndeshje, Ballkani vazhdon të mbajë pozitën e dytë në tabelë me 26 pikë, ndërsa Prishtina renditet në vendin e katërt me 22 pikë. Ndërkaq, në ndeshjen tjetër që u luajt të dielën, mes Suharekës dhe Ferizajt përfundoi baras pa gola (0-0).

Të shtunën u zhvilluan dy ndeshje të javës së 14-të, ku Malisheva arriti një fitore të rëndësishme ndaj Dukagjinit, ndërsa Gjilani si mysafir dominoi përballë Feronikelit '74. Në stadiumin "Liman Gegaj", Malisheva realizoi fitore 2-1 ndaj skuadrës nga Klina. Drilon Hazrollaj e kaloi Malishevën në epërsi në minutën e 19-të. Theophilus Solomon barazoi rezultatit në minutën e 44-t, duke e mbyllur

pjesën e parë në barazim. Megjithatë, tri pikë të reja për malishevasit i siguroi Laurent Xhylani me golin e minutës së 56-të. Malisheva ka 25 pikë dhe është në vendin e tretë, derisa Dukagjini ka 17 pikë dhe është në pozitën e shtatë në tabelë. Në ndeshjen tjetër, Gjilani shfaqti dominim të plotë ndaj Feronikelit 74 në Drenas, duke shënuar fitore bindëse 3:0. Goli i parë erdhi herët nga Senad Jaroviq, i cili realizoi në

minutën e 11-të. Epërsia u dyfishua nga Oltion Bilalli në minutën e 21-të, ndërsa Edi Basha vulosi rezultatit përfundimtar në minutën e 62-të. Pas kësaj fitoreje Gjilani tani ka 17 pikë dhe është në vendin e gjashtë, kurse Feronikeli 74 mbetet në pozitën e fundit në tabelë me vetëm tri pikë. Ndërkohë, java e 14-të e kampionatit do të përmbyllet sot (e hënë) me përballjen mes Dritës dhe Llapit.

## Shqiponja e Samadrexha e përfundojnë stinorin me fitore

Ferizaj, 24 nëntor - Shqiponja dhe Samadrexha e kanë përfunduar me fitore stinorin vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Të dielën Shqiponja arriti fitore të madhe ndaj Kastriotit në Ferizaj me rezultat 35:31. Skuadra

gjakovare ishte vazhdimisht në epërsi, por jo me shumë gola. Kështu ndeshja ishte e fortë thuajse deri në fund. Alma Nivokazi u shqua te Shqiponja me tetë gola. Gjashtë i kishte Orgesa Gola, ndërsa nga pesë i realizuan Larisa Ferizaj, Rosa Silva Ghabriell dhe Helen Da Silva

Souza. 13 gola për Kastriotin i shënoi Bintou Oulare. Nga gjashtë i shtuan Luna Goncalves e Ermira Saliu. Shqiponja është e pesta me 10 pikë, sa i kanë edhe Istogu, Samadrexha e Kastrioti. Kastrioti është i katërti. Në palestrën "Afrim Bunjaku", Samadrexha e

mposhti Besën e Pejës me rezultat bindës, 30:14. Sevdanur Ozkan i shënoi shtatë gola. Gjashtë i kishte Fetane Uzunlar e pesë Arlinda Maloku. Te Besa, Edona Radoniqi i kishte katër gola, ndërsa Adelina Berisha e Elsa Dana i realizuan nga dy. Samadrexha e shënoi



fitoren e pestë. Mban vendin e tretë. Besa mbetet me gjashtë pikë në vendin e gjashtë.



## Rahoveci mposhten nga skuadra rumune

**RAHOVEC, 24 NËNTOR** - Në atmosferë madhështore dhe pa asnjë incident është zhvilluar ndeshja e parë e raundit të tretë të Kupës Evropiane për hendbollistë mes Rahovecit dhe skuadrës së madhe rumune Minaur Baia Mare. Në palestrën "Mizahir Isma" ishin mbi 2 000 shikues, ndërsa tifozët "vreshtarët" u kujdesën për atmosferë të bukur. Fitore

shënoi skuadra rumune Minaur Baia Mare me rezultat 38:31. Skuadra e madhe rumune ishte favorite dhe e arsyetoi këtë me paraqitje. Minaur Baia Mare ishte në epërsi gjithë kohën, por rahovecasit nuk ndalën përpjekjet për rezultat sa më të favorshëm. Në fund dallimi ishte shtatë gola. Portieri Arbër Curri u dallua te Rahoveci me 14

pritje. 9 gola nga 15 tentime i kishte Egzon Gjuka derisa 6 gola nga 9 tentime i kishte Victor Alonso. Stefan Atanasovski i realizoi 4 gola nga 4 tentime. Në përgjithësi ishte një shfaqje e bukur hendbolli e zhvilluar nën masa të rrepta sigurie dhe pa asnjë incident. Ndeshja e kthimit është pas një jave në Rumani.



## 'Dardanët' pësojnë humbje nga Irlanda



**DUBLIN, 24 NËNTOR** - "Dardanët" luftuan deri në fund përballë Irlandës, por pësuan 91:85 (24:12, 18:25, 31:21, 18:27), në parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës 2027. Dy pikët e para të ndeshjes u shënuan nga Kosova, por më pas vendasit hyn në një seri të suksesshme

për 22:2, por "Dardanët" u rikthyen për të ngushtuar diferencën, ku çereku i parë përfundon 24:12. Me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, për të ngushtuar më shumë epërsinë, ku pjesa e parë përfundoi 42:37. Në pjesën e dytë u zhvillua një

ndeshje shumë interesante, ku "Dardanët" luftuan deri në fund për të bërë përmbyshjen, megjithatë, Irlanda fitoi 91:85. Erjon Kastrati nuk luajti për shkak të lëndimit, derisa në fillim u lëndua edhe Erjon Kastrati. Mikailë Tmusiq, Lis Shoshi dhe Malcolm Armstead

u laguan me pesë gabime personale gjatë ndeshjes. Te Kosova, Dardan Berisha shënoi 15 pikë, Lis Shoshi 14, Rron Ukaj dhe Malcolm Armstead nga dhjetë, ndërsa Gëzim Morina kishte nëntë pikë e shtatë kërcime. Kosova e kishte mundur Irlandën në Prishtinë


83:76. Zvicra ka katër fitore, Irlanda dy fitore e dy humbje, ndërsa Kosova dhe Azerbajxhani nga një fitore e tri humbje. Ndeshjet e ardhshme të Kosovës do të jenë në shkurt të vitit të ardhshëm në Prishtinë përballë Azerbajxhanit dhe Zvicrës.

## Shaqiri shënon 'het-trik' për Baselin

**BASEL, 24 NËNTOR** - Baseli shënoi fitore komode me rezultat 3-1 në shtëpi ndaj Servettes në kuadër të javës së 15-të në elitën e futbollit zviceran. Lojtari më meritor për këtë fitore të tyre ishte padyshim ylli shqiptar Xherdan Shaqiri i cili ishte autor i të tre golave të realizuar. Shaqiri shënoi fillimisht një super gol në pjesën e parë për t'i dhënë

epërsinë Baselit prej 1-0, rezultat me të cilin u mbyllën 45 minutat e para të këtij takimi. Dy golat e radhës, Shaqiri i shënoi krejt në fund të takimit, më saktësisht në minutën e 91-të dhe në minutën e 92-të respektivisht për rezultat në përfundimtar 3-1 në të mirë të Baselit. Për këtë paraqitje të jashtëzakonshme, 33-vjeçari u shpall lojtari më i

mirë i ndeshjes sipas "Sofascore" duke marrë notën 9.3. Përveç tre golave të shënuar, Shaqiri gjithashtu pati katër pasime kyçe, dy driblime të kompletuara, shtatë duele të fituara dhe 27 pasime të kompletuara. Me këtë "het-trik", Shaqiri shkon në kuotën e pesë golave të realizuar këtë sezon në kampionat teksa ka shtatë asistime





## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Zyrtar për Analiza të Investimeve  
**Departamenti:** Departamenti për Menaxhimin e Mjeteve  
**Niveli i gradës:** 6  
**Raporton:** Udhëheqësit të Divizionit për Investime

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë raporte mujore, gjashtëmujore dhe vjetore për Divizionin e Investimeve në pajtim me zbatimin e Politikës Investive;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve për Komitetin e Investimeve dhe Likuiditetit;
- Kujdeset për hulumtimet dhe operacionet ditore të investimeve të Zyrës së Pasmë në mungesë të Zyrtarit të Operacioneve Investive;
- Kryen analizat ditore të likuiditetit dhe përpunon informatat ditore të tregut dhe paraqet efektin e tyre në vendimet investive;
- Kontrollon gjendjen e llogarive tona ditore (llogaritë nostro të BQK-së) në baza ditore;
- Kordinon aktivitetin e investimeve me Zyrën së Pasmë dhe Auditimin e Brendshëm lidhur me të gjitha transkacionet e procesuara në i-flex;
- Mban kontakt me zyrtarët e llogarive dhe dilerëve të bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Grumbullon, monitoron dhe analizon të gjitha informatat relevante në lidhje me tregjet financiare botërore në baza ditore nga Bloombergu;
- Njofton klientët e BQK-së për ndryshimin e normës referuese;
- Hulumton dhe përcjell gjendjen e bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Hulumton bankat potenciale për mundësitë e reja të investimeve;
- Kryen analiza rreth gjendjes së tregut financiar dhe jep sugjerime të bazuara në këto analiza;
- Përgatitë raporte mbi tregjet financiare dhe ngjarjet ekonomike;
- Informon në baza ditore lidhur për lëvizjen e EONIA-s dhe Euribor-it dhe mundësinë e ndryshimit të normës së instrumentit depozitar (deposit facility rate);
- Kryen përgatitjen e raporteve (ad hoc raporteve) lidhur me Rangimin Kreditor dhe të tjera punë të Zyrës Frontale;
- Detyrat tjera të cilat caktohen kohë pas kohe nga Mbikqyrësi.

### Dituritë e kërkuara:

- Diplomë universitare.
- Përvoja në sistemin financiar, banka komerciale apo në ndonjë institucion tjetër financiar;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;

### Përvoja e kërkuar:

- Minimum dy (2) vite përvojë pune profesionale në sistemin financiar, banka komerciale apo në ndonjë institucion tjetër financiar.

### Kërkesat e posaçme:

- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve
- Aftësi të shkëlqyera kuantitative dhe analitike.
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office të ngjashme;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Ruajtja e fshehtësisë afariste.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

**Pozicija:** Službenik za investicionu analizu  
**Odeljenje:** Sektor za upravljanje sredstvima  
**Nivo stepena:** 6  
**Izveštava:** Rukovodiocu Odseka za investicije

### Dužnosti i odgovornosti:

- Priprema mesečne, šestomesečne i godišnje izveštaje za Investicioni odsek u skladu sa sprovođenjem investicione politike;
- Pomaže u pripremi izveštaja za Komitet za investicije i likvidnost;
- Brine o istraživanju i svakodnevnom poslovanju investicija Pozadinsku kancelariju u odsustvu službenika za investicione operacije;
- Obavlja dnevne analize likvidnosti i obrađuje dnevne informacije o tržištu i predstavlja njihov uticaj na investicione odluke;
- Svakodnevno proverava stanje naših dnevnih računa (nostro račune CBK-a);
- Koordinira investicionu aktivnost sa Pozadinskom kancelarijom i unutrašnjom revizijom u vezi sa svim transakcijama obrađenim u i-flex;
- U kontaktu je sa računovodstvenim i biračkim službenicima banaka sa kojima BANKA saraduje;
- Prikuplja, prati i analizira sve relevantne informacije o svetskim finansijskim tržištima na dnevnoj bazi od Bloomberg;
  - Obaveštava klijente CBK-a o promeni referentne stope;
  - Istražuje i ispituje stanje banaka sa kojima BQK saraduje;
  - Istražuje potencijalne banke za nove mogućnosti investicija;
  - Sprovodi analizu stanja na finansijskom tržištu i daje sugestije na osnovu tih analiza;
  - Priprema izveštaje o finansijskim tržištima i ekonomskim događajima;
  - Svakodnevno obaveštava o kretanju EONI-a i Euribor-a i mogućnosti promene stope stalno raspoložive mogućnosti deponiranja depozita;
  - Vrši pripremu izveštaja (ad hoc izveštaja) u vezi sa Kreditnim rangiranjem i drugim poslovima Pozadinske kancelarije;
  - Ostale dužnosti koje povremeno dodeljuje supervizor.

### Potrebno znanje:

- Univerzitetska diploma.
- Iskustvo u finansijskom sistemu, komercijalnoj banci ili bilo kojoj drugoj finansijskoj instituciji;
- tečno poznavanje govornog i pisanog jezika albanskog i/ili srpskog;
- Znanje engleskog jezika je prednost.

### Potrebno iskustvo:

- Minimalno dve (2) godine profesionalnog iskustva u finansijskom sistemu, komercijalnoj banci ili bilo kojoj drugoj finansijskoj instituciji.

### Posebni zahtevi:

- Sposobnosti pisanja i rešavanja problema prema prioritetima
- Odlučne kvantitativne i analitičke sposobnosti.
- Odlučno poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office i slično;
- Pažnja na detalje, u jasnim i preciznim formulacijama;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Čuvanje poslovnih tajna.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Pratno (motivaciono) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokazi o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje radnog mesta i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Fonda penzijske štednje Kosova (Trusti) za odgovarajući period, ili poresko uverenje Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Trusta nije zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za utvrđivanje državnosti Kosova.

### Postupak apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **10. decembar 2024**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Prijavni obrazac možete preuzeti preko internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA

# 1992

